



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.66/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ZL.Anr.66/2025 datë 29.09.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) euro.

III. Detyrohen Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojë posterat e vendosur në rrugën "Bill Clinton" dhe në rrugën "Tirana" në Prishtinë, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 26.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën theksohet se më datë 25.09.2025 aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë identifikuar banerët e vendosura në hapësirat publike, përkatësisht në rrugët "Bill Clinton" dhe "Tirana".

Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore, konkretisht të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Si prove në ankesë ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigje në ankesë kanë deklaruar se kanë vepruar në mënyrë të rregullt, duke respektuar legjislacioni në fuqi dhe procedurat e parapara për vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësirat publike. Kanë shtuar se më autorizimin nr.75/2025, të datës 19.09.2025, LDK ka autorizuar Kompaninë “As Studio”, në Prishtinë që në emër dhe për llogari të saj të aplikoj pranë të gjitha organeve kompetente për marrjen e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme, të ndjek procedurat administrative, si dhe të vendosë materialet zgjedhore për të cilat është kontraktuar. Në përgjigje në ankesë kanë shtuar se bazuar në këtë pëlqim kompania “As Studio” ka aplikuar dhe është pajisur me pëlqimin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prishtinë, me nr. 07.353/02144185, të datës 22.09.2025. Ky pëlqim parashih vendosjen e 20 tabelave informuese në lagje dhe në parqe të qytetit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga organet komunale. Materialet janë vendosur vetëm në pikat e miratuar dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur Autorizimin me numër 75/25, të datës 19.09.2025 ndaj “As Studio”, si dhe Pëlqimin e lëshuar nga Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Shërbimeve Publike, me numër 07.353/02-144185, të datës 22.09.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se kandidati për kryetar të Komunës nga radha e Lidhjes Demokratike të Kosovës, përkatësisht Përparim Rama ka vendosur postera zgjedhorë në rrugët “Bill Clinton” dhe në rrugën “Tirana”, në Prishtinë, duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së tyre.

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që janë shfrytëzuar hapësirat publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 nën paragrafi 2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se 1.2.” *vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, pretendohet se për vendosjen e materialeve reklamuese-postereve kanë autorizuar Kompaninë “As Studio” 75/25, të datës 19.09.2025, që në emër dhe për llogari të saj të aplikoj pranë të gjitha

organeve kompetente për marrjen e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme, të ndjek procedurat administrative, si dhe të vendosë materialet zgjedhore për të cilat është kontraktuar, dhe që e njëjta e ka marrë edhe pëlqim nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Pëlqimit me nr. të referencës 07.353/02144185, të datës 22.09.2025, lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, ka vërejtur se me këtë vendim i është dhënë pëlqimi Kompanisë “As Studio”, për vendosjen e 20 tabelave që shërbejnë si pika informuese. Në këto rrethana Paneli konstatoi se në Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike nuk është cekur se kjo kompani ka të lidhur kontratë me subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës ashtu që të mund të vendos tabela informuese për të. Duke marr parasysh faktin se nuk ekziston një kontratë e lidhur konkludojmë se Kompania “As Studio”, nuk mund të vendos postera-banera në emër të subjektit politik LDK.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, përkatësisht kandidati për kryetar Përparim Rama ka shfrytëzuar hapësirat publike gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimi i këtij kandidati bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik LDK ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik LDK, si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se ky subjekt më herët nuk ka bërë një shkelje të tillë, përkatësisht nuk është dënuar më parë për vendosjen e posterëve gjatë këtij procesi zgjedhor.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati Përparim Rama, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin e vendosur në rrugën “Bill Clinton”, dhe “Tirana”, ndërsa dështimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 1.3, nenit 36 paragrafi 1.2 neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.66/2025 më datën 29.09.2025

**Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi**



KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*